

32001D0419

2001/419/ÇBD: VENDIMI I KËSHILLIT, DATË 28 MAJ 2001, "PËR DËRGIMIN E KAMPIONËVE TË SUBSTANCAVE TË KONTROLLUARA"

Gazeta Zyrtare L 150, 06/06/2001 F. 0001 - 0003

(2001/419/ÇBD)

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian dhe në veçanti nenin 30, nenin 31 dhe nenin 34, paragrafi 2, germa "c" të tij,

Duke pasur parasysh nismën e Mbretërisë së Suedisë,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian¹,

Meqë:

1. Lufta kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të drogës përfaqëson një shqetësim të përbashkët për autoritetet ligjzbatuese dhe autoritetet e drejtësisë në shtetet anëtare.

2. Mundësia e dërgimit ligjor të kampionëve të substancave të kontrolluara të konfiskuara ndërmjet autoriteteve të shteteve anëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale ose për analizën ligjore të kampionëve, do të rriste efektivitetin e luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të drogës.

3. Aktualisht nuk ekzistojnë rregulla ligjrisht detyruese që rregullojnë dërgimin e mostrave të konfiskuara të substancave të kontrolluara narkotike ndërmjet autoriteteve të shteteve anëtare. Prandaj duhet krijuar një sistem në nivel Bashkimi Evropian që mundëson dërgimin ligjor të këtyre kampionëve. Një sistem i tillë duhet të zbatohet për të gjitha format e dërgimit të kampionëve të substancave të kontrolluara të konfiskuara ndërmjet shteteve anëtare. Dërgimi duhet të bazohet në marrëveshjet midis shtetit anëtar dërgues dhe atij marrës.

4. Dërgimi duhet të ndodhë në një mënyrë të sigurt dhe që garanton mosabuzimin me kampionët e dërguar,

VENDOS SI MË POSHTË:

Neni 1

Krijimi i një sistemi për transmetimin e kampionëve

1. Ky vendim krijon një sistem për dërgimin e kampionëve të substancave të kontrolluara ndërmjet shteteve anëtare.

2. Dërgimi i kampionëve të substancave të kontrolluara (në vijim "kampionet") konsiderohet i ligjshëm në të gjitha shtetet anëtare kur kryhet në përputhje me këtë vendim.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij vendimi, substancat e kontrolluara janë:

a) të gjithë substancat, natyrale ose sintetike, të përmendura në shtojcat I ose II të Konventës së vetme të Kombeve të Bashkuara për drogat narkotike së vitit 1961 dhe atë Konventë të ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972;

b) të gjithë substancat e përmendura në shtojcat I, II, III dhe IV të rishikuara të Konventës së Kombeve të Bashkuara për substancat psikotrope së vitit 1971;

c) të gjithë substancat që u nënshtrohet masave të kontrollit të marra në përputhje me nenin 5, paragrafi 1 të Veprimit të Përbashkët 97/396/ÇBD të 16 qershorit 1997 "Për shkëmbimin e informacionit, vlerësimin e rrezikut dhe kontrollin e drogave të reja sintetike"².

Neni 3

Pikat kombëtare të kontaktit

1. Çdo shtet anëtar cakton një pikë kombëtare kontakti për qëllimet e zbatimit të këtij vendimi.

2. Informacioni lidhur me pikat e caktuara kombëtare të kontaktit, përfshirë ndryshimet pasuese, i përcillet Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit, i cili e boton atë në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

3. Pikat kombëtare të kontaktit, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me organet e tjera kombëtare përkatëse, janë organet e vetme kompetente për autorizimin e dërgimit të kampioneve në zbatim të këtij vendimi, pavarësisht nga dispozitat përkatëse për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale.

Neni 4

Marrëveshja për dërgimin e kampioneve dhe konfirmimi i marrjes

1. Pika kombëtare e kontaktit e shtetit anëtar që synon të dërgojë një kampion dhe pikat kombëtare të kontaktit të shtetit anëtar që kanë për qëllim marrjen e kampionit duhet të bien dakord për transportin përpara se të kryhet dërgimi. Për këtë qëllim ata përdorin Formularin e Dërgimit të Kampionit të përcaktuar në shtojcë.

2. Kur dërgimi i një kampioni përfshin transportin nëpërmjet territorit të një shteti tjetër anëtar (në vijim "shteti anëtar i transitit), pika kombëtare e kontaktit e shtetit anëtar të transitit njoftohet në vijim për transportin e planifikuar nga pika kombëtare e kontaktit e shtetit anëtar dërgues. Për këtë qëllim, çdo shtet anëtar i transitit merr një kopje të plotësuar të Formularit të Dërgimit të Kampionit, përpara se të fillojë dërgimi.

3. Shteti anëtar marrës i konfirmon shtetit anëtar dërgues marrjen e kampionit.

Neni 5

Mjeti i transportit

1. Transporti i kampioneve kryhet në një mënyrë të sigurt.

2. Mënyrat e mëposhtme të transportit konsiderohen si të sigurta:

a) transportimi nga një nëpunës zyrtar i shtetit anëtar dërgues ose marrës;

b) transporti me korrier;

c) transporti me çantë diplomatike;

d) transporti me postë të regjistruar (ekspres).

3. Formulari i Dërgimit të Kampionit i plotësuar si duhet, i përmendur në nenin 4 duhet të shoqërojë kampionin gjatë gjithë transportit.

4. Autoritetet e shteteve anëtare të përfshira nuk pengojnë apo ndalojnë asnjë transport të shoqëruar me një Formular të Dërgimit të Kampionit të plotësuar siç duhet, përveç se kur ata dyshojnë për faktin nëse transporti kryhet sipas ligjit ose jo. Në rast dyshimi në lidhje me statusin ligjor të Formularit të Dërgimit të Kampionit, pikat kombëtare të kontaktit të shtetit anëtar që ndalon transportin, kontaktojnë pa vonesë pikat kombëtare të kontaktit të shteteve anëtare përgjegjëse për plotësimin e Formularit të Dërgimit të Kampionit për të sqaruar çështjen.

5. Nëse dërgimi bëhet nëpërmjet një zyrtari të shtetit anëtar dërgues ose marrës, ky zyrtar nuk lejohet të mbajë uniformë. Për më tepër, ai nuk kryen asnjë detyrë operacionale në lidhje me transportin, përveç nëse kjo do të ishte në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi dhe e miratuar nga shtetet anëtare dërguese, të transitit ose pranuese. Për udhëtimin me një mjet fluturimi, përdoren vetëm kompanitë ajrore të regjistruara në një nga shtetet anëtare.

Neni 6

Sasia e kampionit dhe përdorimi i tij

1. Një kampion nuk tejkalon sasinë e përcaktuar si të nevojshme për qëllime të zbatimit të ligjit dhe juridike ose për analizën e kampionit.

2. Përdorimi i kampionit brenda shtetit anëtar pranues miratohet nga shteti anëtar dërgues dhe ai pranues, duke kuptuar se mostrat mund të përdoren për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale ose për analizën shkencore të mostrave.

Neni 7

Vlerësimi

1. Ky vendim është objekt i vlerësimit brenda Këshillit pas të paktën dy ose më shumë se pesë vjet pas hyrjes së tij në fuqi.

2. Për qëllimin e vlerësimit, pika kombëtare e kontaktit e secilit prej shteteve anëtare ruan në arkivat e tij një kopje të çdo Formulari të Dërgimit të Kampionit të lëshuar gjatë të paktën pesë viteve të fundit.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2001.

Nënshkruar në Bruksel, më 28 maj 2001.

Për Këshillin

Presidenti

T. Bodström

SHTOJCA

>PIC FILE= "L_2001150EN.000302.EPS">

-
1. Opinioni i dërguar më 4 maj 2001 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare).
 2. *Gazeta Zyrtare L 167, 25.6.1997, f. 1.*
-